

POLITIKA E PRIVATËSISË

WWW.RATECH.AL

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Si pjesë e angazhimit tonë për të qenë ofruesi më i mirë i shërbimeve për klientët tanë, RATECH është i dedikuar për të mbrojtur privatësinë e atyre që vizitojnë faqet tona të internetit dhe me të cilët ne bëjmë biznes. Ne e kuptojmë rëndësinë që ka për ju ruajtja e sigurisë së informacionit.

1.2. Si pjesë e veprimtarisë sonë të zakonshme, ne mbledhim lloje të ndryshme informacioni rreth vizitorëve të faqeve tona. Megjithatë, ne i kemi strukturuar faqet tona në mënyrë që njerëzit të kenë mundësinë të vizitojnë pa e identifikuar veten ose pa zbuluar ndonjë informacion personal.

1.3. Më poshtë janë veprimet që mund të kryeni kur vizitoni faqen tonë, nëse NUK preferoni që ne të mbledhim informacion në lidhje me vizitën tuaj:

1.3.1. Çaktivizoni *cookies* brenda programit tuaj të lundrimit në internet përpara se të vizitoni faqen tonë;

1.3.2. Zgjidhni të mos dërgoni informacion përmes formularëve të kontaktit të vendosur brenda faqes sonë;

1.3.3. Zgjidhni të mos plotësoni sondazhet që mund të ndodhen në faqen tonë;

1.3.4. Zgjidhni të mos aplikoni për ndonjë vend pune të publikuar në faqen tonë.

2. COOKIES

2.1. Siç vepohet zakonisht në faqet e internetit, ne mund të përdorim *cookies* dhe teknologji të ngjashme për të kontrolluar veprimtarinë e përdoruesve tanë. “*Cookie*” është një skedar i vogël me tekst, që përmban karaktere alfanumerike dhe që ruhet në kompjuterin tuaj dhe identifikon në mënyrë unike programin tuaj të lundrimit në internet.

2.2. Ne mund të regjistrojmë informacione që programi juaj i lundrimit në internet ndan në mënyrë rutinore, si: lloji dhe gjuha e programit, atributet e programit dhe kompjuterit tuaj, data dhe ora e vizitës suaj, faqja e internetit nga e cila keni hyrë në faqen tonë, vendndodhja gjeografike e adresës së Protokollit të Internetit dhe seksionet që vizitoni në faqen tonë. Këto janë përgjithësisht të dhëna anonime, që ne i përmbledhim për të gjithë përdoruesit. Ne i përdorim këto informacione për të monitoruar trafikun e faqes sonë dhe për të kuptuar sjelljen e vizitorëve. Këto metoda nuk mbledhin ndonjë informacion personal, por thjesht informacion të përmbledhur që na lejon të shqyrtojmë modelet e sjelljes në faqen tonë për të mësuar se si t’i plotësojmë më mirë nevojat e vizitorëve tanë.

2.3. Duke përdorur këtë faqe, ju pranoni përdorimin si më sipër të të dhënave tuaja. Ju mund të refuzoni *cookies*, duke i çaktivizuar në seksionin përkatës të programit tuaj të lundrimit në internet.

3. INFORMACIONI QË MBLEDHIM

3.1. Ju mund ta vizitoni faqen tonë për arsye të ndryshme. Për qëllimet e kësaj politike të privatësisë, ne do t’i klasifikojmë arsyet e vizitave në dy kategori, për të cilat mbledhim dhe ruajmë lloje të ndryshme të të dhënave:

3.1.1. shfletim i përgjithshëm;

3.1.2. dorëzim i formularëve.

3.2. Nëse thjesht shfletoni në mënyrë të përgjithshme faqen tonë, ne përmbledhim informacion në lidhje me kompjuterin tuaj dhe seksionet që vizitoni në faqen tonë në

tërësi (jo informacione individuale ose personale). Këto të dhëna shpesh quhen të dhëna të klikimit ose të navigimit. Ne e përdorim këtë informacion për analizim dhe raportim, në mënyrë që të përmirësojmë lundrimin, strukturën dhe përmbajtjen e faqes sonë.

3.3. Disa seksione të faqes sonë përmbajnë formularë që ju lejojnë të kërkonit informacion në lidhje me shërbimet dhe zgjidhjet tona në këmbim të informacionit të kontaktit. Gjatë plotësimit të këtyre formularëve, mund t’ju kërkohet të jepni informacione kontakti, siç janë emri juaj, emri i kompanisë, adresa, numri i telefonit dhe adresa e emailit. Duke plotësuar një formular në këtë faqe, ju pranoni politikën tonë të privatësisë. Ju pranoni gjithashtu që të dhënat tuaja mund të mos jenë subjekt i rregulloreve të BE-së, si p.sh Rregullorja (EU) 2016/679 (“GDPR”), pasi kjo është një kompani dhe një faqe e bazuar në Shqipëri.

4. SI E PËRDORIM DHE SHPËRNDAJMË INFORMACIONIN TUAJ

4.1. Të dhënat tuaja personale, të marra në mënyrat e sipërpërmendura, përveçse për qëllimin e shprehur për të cilin janë dhënë, mund të përdoren edhe për aktivitetet e mëposhtme, në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm:

4.1.1. ekzekutimin e detyrimeve tona, të cilat rrjedhin nga çdo kontratë e lidhur mes nesh apo mes punëdhënësit tuaj dhe nesh;

4.1.2. kërkimin e pikëpamjeve ose komenteve tuaja mbi shërbimet që ne ofrojmë, përmes sondazheve ose mënyrave të tjera të ngjashme;

4.1.3. njoftimin për ndryshimet në shërbimet tona;

4.1.4. dërgimin e komunikimeve të kërkuara prej jush apo që mund t’ju interesojnë, duke përfshirë aktivitete ose promovime të produkteve ose shërbimeve tona, ose atyre të partnerëve tanë;

4.1.5. rimarketimin tuaj në faqet e internetit të palëve të treta;

4.1.6. dërgimin e buletineve, njoftimeve dhe lajmërimeve;

4.1.7. kontaktimin tuaj përmes telefonit.

4.2. Kur është e përshatshme, ne mund ta përdorim informacionin tuaj personal ose mund ta shpërndajmë atë tek partnerë të zgjedhur, për të na ndihmuar t’ju sigurojmë juve ose kompanisë suaj produkte ose shërbime, ose për të përmbushur kërkesat tuaja, ose kur ju keni dhënë pëlqimin e shprehur. Gjatë zgjedhjes së furnitorëve dhe partnerëve tanë, ne marrim parasysh proceset e tyre të trajtimit të të dhënave personale.

4.3. Nëse nuk dëshironi që ne të përdorim të dhënat tuaja në mënyrat e përshkruara më sipër, ndiqni udhëzimet më poshtë, në seksionin “Të drejtat tuaja”.

4.4. Në rrethana të caktuara, informacioni juaj personal mund t’u jepet organeve shtetërore në kuadër të procedurave hetimore a gjyqësore apo në zbatim të një vendimi të gjykatës. Gjithashtu, ne mund ta shpërndajmë informacionin tuaj personal për të mbrojtur të drejtat ose pronën tonë ose të partnerëve tanë të biznesit, furnitorëve ose klientëve ose personave të tjerë, kur kemi arsye të bazuara për të besuar se të këto të drejta ose prona janë cënuar apo mund të cënohen.

4.5. Ne mund të vendosim lidhje elektronike dhe formularë në këtë faqe për t’ju mundësuar të na kontaktoni

NUIS: L11521021S

drejtpërdrejt. Informacioni që jepni do të përdoret për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt pyetjeve ose komenteve tuaja. Këto komente mund të ruhen për të përmirësuar cilësinë e faqes dhe shërbimeve tona.

5. SIGURIA DHE KORREKTËSIA E TË DHËNAVE

5.1. Ne jemi të dedikuar t'i mbrojmë të dhënat tuaja personale dhe të ruajmë saktësinë e tyre. Ne zbatojmë masa mbrojtëse fizike, administrative dhe teknike të arsyeshme për të na ndihmuar të mbrojmë të dhënat tuaja personale nga hyrja, përdorimi dhe zbulimi i paautorizuar. Ne, gjithashtu, kërkojmë që edhe partnerët tanë të mbrojnë të dhënat personale nga hyrja, përdorimi dhe zbulimi i paautorizuar.

6. PERIUDHA E MBAJTJES

6.1. Ne jemi të dedikuar që të mos i mbajmë të dhënat personale më gjatë sesa është e nevojshme për të përbushur qëllimet për të cilat ato janë mbledhur.

6.2. Nëse i kemi mbledhur të dhënat tuaja për qëllime marketingu, ne do t'i fshijmë ato nëse nuk kemi marrë ndonjë përgjigje për aktivitetet tona të marketingut gjatë një periudhe tre vjeçare. Fshirja do të ndodhë brenda gjashtë muajve nga kalimi i periudhës tre-vjeçare.

7. SI TË NA KONTAKTONI

7.1. Nëse keni pyetje në lidhje me këtë politikë të privatësisë, ju lutemi, na kontaktoni duke dërguar një email tek info@ratech.al. Mesazhi juaj duhet të përmbajë emrin e kompanisë suaj dhe detajet specifike të kërkesës.

7.2. Në zbatim të Rregullores (EU) 2016/679 ("GDPR") dhe Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", kontrolluesi i të dhënave tuaja personale është RATECH sh.p.k., Rruga e Kavajës, Park Construction Albania, Godina D, Hyrja A, Tiranë, Shqipëri.

7.3. RATECH nuk është kontrolluesi i të dhënave në rastet e të dhënave personale të mbledhura në lidhje me një marrëdhënie kontraktore. Në këto raste, kontrolluesi i të dhënave personale është kompania me të cilën kemi kontraktuar, përveçse nëse kontrata parashikon ndryshe.

8. TË DREJTAT TUAJA

8.1. Ju mund të revokoni pëlqimin tuaj për këtë politikë duke dërguar një email tek info@ratech.al.

8.2. Ju mund të kërkonit të aksesoni, azhurnoni ose korrigjoni të dhënat tuaja personale. Gjithashtu, ju keni të drejtë të kundërshtoni marketingun e drejtpërdrejtë. Për të bërë një kërkesë apo një kundërshtim të tillë, ju lutemi, dërgoni një email tek info@ratech.al. Ju lutemi, jepni detajet e kërkesës tuaj. Ne do t'ju kontaktojmë nëse na duhen më shumë informacione për të përpunuar kërkesën tuaj.

8.3. Ju mund të keni të drejta të tjera në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Ju mund t'i bëni këto kërkesa duke dërguar një email tek info@ratech.al.

9. FËMIJËT

9.1. Ne shqetësohemi për privatësinë e fëmijëve dhe nuk mbledhim me vetëdije ndonjë të dhënë personale nga një fëmijë nën moshën 15 vjeç. Nëse vijnë në dijeni se kemi mbledhur të dhëna personale për një fëmijë nën moshën 15 vjeç, ne do t'i fshijmë menjëherë këto të dhëna nga sistemet tona.

10. SIGURIA

10.1. Ne përdorim masa procedurale dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale nga humbja, hyrja e paautorizuar, zbulimi, ndryshimi ose shkatërrimi. Sidoqoftë, ne nuk mund të garantojmë që palët e treta nuk do t'i kapërcejnë këto masa dhe nuk do të kenë akses në të dhënat tuaja personale për qëllime të paautorizuara. Duke përdorur faqen tonë, ju pranoni që ekziston rreziku që të dhënat tuaja të bëhen objekt i aksesit të paautorizuar. Në masën që lejohet nga ligji, ne heqim dorë nga çdo garanci ose premtim se të dhënat tuaja janë krejtësisht të mbrojtura nga keqpërdorimi, përvetësimi, ndryshimi ose humbja.

11. LIDHJET

11.1. Kjo faqe mund të përmbajë lidhje elektronike me faqe të tjera në internet. Ju lutemi të mbanini parasysh se ne nuk jemi përgjegjës për praktikën e privatësisë së faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë që të lexoni deklaratat e privatësisë të secilës faqe në internet që mbledh të dhëna personalisht të identifikueshme. Kjo deklaratë e privatësisë zbatohet vetëm për të dhënat e mbledhura nga kjo faqe.

12. ZBULIMI I INFORMACIONIT

12.1. Ne mund të zbulojmë ose të aksesojmë të dhënat tuaja personale kur besojmë, në mirëbesim, se kjo kërkohet nga ligji apo kur ka një kërkesë nga autoritetet e zbatimit të ligjit, në lidhje me një hetim penal, ose nga autoritetet civile ose administrative, në lidhje me një çështje civile ose procedurë administrative.

13. KUSHTET E PËRDORIMIT

13.1. Përmbajtja e kësaj faqeje është material i mbrojtur nga e drejta jonë e autorit. Kjo përmbajtje sigurohet vetëm për informacionin tuaj të përgjithshëm dhe mund të ndryshojë pa paralajmërim. Ne rezervojmë të gjitha të drejtat në lidhje me faqen tonë e internetit, duke përfshirë të drejtat e autorit dhe të drejtat e pronës intelektuale, pa asnjë kufizim.

13.2. Faqja jonë në internet ofrohet "siç është". Ne nuk bëjmë asnjë përfaqësim dhe as nuk japim garanci të çfarëdo lloji, të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me saktësinë, plotësinë, përshtatshmërinë, përpikmërinë, disponueshmërinë ose besueshmërinë e faqes në internet ose të informacionit ose të materialeve të gjetura ose të ofruara në këtë faqe. Ne heqim dorë nga të gjitha garancitë e nënkuptuara, duke përfshirë garancinë për funksionim, për realizimin e qëllimit, saktësinë e të dhënave dhe mungesën e shkeljeve, pa asnjë kufizim.

13.3. As ne, as ndonjë nga kompanitë tona të lidhura, drejtorët, punonjësit, ortakët ose pronarët nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë humbje ose dëmtim në lidhje me përdorimin e kësaj faqeje në internet.

13.4. Çdo pretendim ose veprim ligjor që rrjedh nga përdorimi i faqes në internet ose ka të bëjë me të, do të rregullohet nga ligjet e shtetit shqiptar, pavarësisht se ku u aksesua faqja në internet apo pavarësisht nga vendi i origjinës së pretenduesit.

PYETJE NË LIDHJE ME POLITIKËN E PRIVATËSISË

Nëse keni pyetje ose ankesa për këtë politikë të privatësisë, praktikën e kësaj faqeje ose ndërvpërimin tuaj me të, ju lutemi na kontaktoni tek info@ratech.al.